



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.,

Datë _____._____.2025

V E N D I M

Nr. 15, datë 25.09.2025

**PËR
MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT TË RREGULLORES
“PËR MONITORIMIN E SPEKTRIT TË FREKUENCAVE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 25 shtator 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“Miratimin për këshillim publik të dokumentit – “Projektregullore “Për Monitorimin e Spektrit të Frekuencave”.***

BAZA LIGJORE:

1. Gërma “dh”, pika 1 e nenit 12, neni 44 dhe neni 64 i ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin nr. 21, datë 07.12.2021, të Këshillit Drejtues të AKEP;
3. Dispozitat e Radio Rregullores së Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU) dhe Udhëzuesit mbi Monitorimin e Spektrit (Handbook on Spectrum Monitoring - ITU).

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti i përgatitur nga Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme për këshillim publik: “Për Monitorimin e Spektrit të Frekuencave”;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Dokumenti Projektregullore “*Për monitorimin e spektrit të frekuencave*”, vjen si rezultat i domosdoshmërisë për të përditësuar kuadrin nënligjor në fushën e monitorimit të spektrit të frekuencave dhe atij të administrimit të interferencave, në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ky dokument:
 - a. përbën një përmbledhje të vetme të dy rregulloreve ekzistuese, nr. 34 “*Për monitorimin e frekuencave*” dhe nr. 35 “*Për administrimin e interferencave*” i cili synon të shmangë mbivendosjet dhe të normojë boshllëqet proceduriale që ekzistojnë në aktet e ndara;
 - b. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara në gërmat “dh” të pikës 1, të nenit 12, neneve 64, , të ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
 - c. ka marrë në konsideratë dispozitat e rregullores së ITU-së, rekomandimet e CEPT dhe manualit të ITU-së për monitorimin.
4. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024, dhe Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, pikën 1 të nenit 15 dhe nenit 44 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit: Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e Këshillimit Publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP.

3. Ky Vendim dhe Dokumenti për Këshillim Publik Rregullorë “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, të publikohen në faqen e internetit të AKEP : www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka